



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të Nenit 17 paragrafi 1 pika 10, Neni 22, Neni 23 paragrafi 1 i Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019), Neni 40 dhe Neni 41 i nga Rregullorja e Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK) në seancën e 50 -të të mbajtur me datë 21.07.2021 morri;

## VENDIM

Denoncimi me numër në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit me numrin 08-1771 / 1 të datës 04.05.2021, nga një parashtrues i panjohur, REFUZOHET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka bazë për veprim kompetent të KSHPK-së në lëndën me numër 08-1771 / 1 të datës 04.05.2021.

Denoncimi të dorëzohet në veprimin kompetent të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Lënda me numër 08-1771 / 1 të datës 04.05.2021 të mbyllet dhe arkivohet.

Vendimi i KSHPK -së, me arsyetim, në formë të depersonalizuar, të publikohet në faqen e internetit të KSHPK -së brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i saj.

## Arsyetim

Lënda me numër 08-1771 / 1 të datës 04.05.2021 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga një parashtrues i panjohur (denoncim anonim).

Në denoncim janë nxjerr pohime për pronën e fituar në mënyrë të paligjshme nga personi \_\_\_\_\_, i cili kërkon ekzaminim të origjinës së pronës së personit të theksuar dhe pronës së anëtarëve të familjes së tij.

Në denoncim përmendet se personi i emëruar ka kryer disa funksione dhe pozicione, të tilla si \_\_\_\_\_, këshilltar \_\_\_\_\_ si dhe zëvendës drejtor i \_\_\_\_\_, ku ai ka fituar në mënyrë të paligjshme prona

të paluajtshme dhe prona të luajtshme përmes veprimeve kriminale, dallavere dhe të ngjashme.

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së denoncimit, dhe nga kontrollet e kryera administrative, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit përcaktoi se në rastin konkret bëhet fjalë për person i cili aktualisht nuk ka statusin e personit zyrtar sepse në përputhje me dispozitat e Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe konfliktin e interesave nuk ka bazë për veprimin e tij kompetent në rastin konkret.

Në të njëjtën kohë, duke pasur pohimet e paraqitura në denoncim për veprime të paligjshme nga personi i caktuar, KSHPK arriti në përfundimin se denoncimi duhet t'i dorëzohet veprimit kompetent të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Duke pasur parasysh të theksuaren e mësipërme, Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Punoi: A.Ç, udhëheqës i njësisë  
Miratoi: S.P.D., anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
KRYETAR,  
Biljana Ivanovska**

